

MINISTRI

Zonja Milva Ekonomi ka lindur në Tiranë në vitin 1962 dhe është nënë e dy vajzave.

Ka kryer studimet e larta në Statistikë dhe Ekonomi nga Universiteti i Bujqësisë, dhe një Master në Administrim Biznesi (MBA) nga Universiteti i Tiranës. Ka kryer gjithashtu edhe formime të avancuara në fushën e statistikave ekonomike dhe sociale si dhe të menaxhimit në Byrone e Statistikave të Punës (SHBA), Eurostat (Luxemburg), Istat (Itali).

Znj. Ekonomi ka qënë zëvendës Ministre e Shendetësisë (2013-2016).

Ka shërbyer si Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Statistikave të Shqipërisë gjatë periudhës 1994-2005 duke kryer një sërë detyrash që lidheshin me ngritjen dhe institucionalizimin e statistikave zyrtare në vend.

Ka kryesuar Komisionin Kombëtar të Nomenklaturave dhe ka qënë për dy mandate anëtare e Byrosë së Konferencës së Statisticienëve Evropianë KEE/OKB. Në vitin 2006 ajo zgjidhet anëtare e panelit të ekspertëve të projektit “PARIS 21” (OECD), ku punon mbi lidhjen e statistikave zyrtare me të drejtat e njeriut. Punon në këtë projekt deri në fund të dhjetorit 2007.

Më pas ajo u përfshi si ekspert kyç në Agjencinë Evropiane për Rindërtim (EAR) në Kosovë, në projektin mbi Mbështetjen në Sistemin Statistikor dhe Përgatitjen e Rregjistrimit të Popullsisë në Kosovë 2007 - 2008.

Dha kontributin e saj si Këshilltar Afatgjatë i Statistikave Suedeze (Sida) në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, ku punoi gjatë viteve 2008 – 2013, në hartimin e legjislacionit statistikor dhe ndërtimin e Programit Zyrtar të Statistikave Kombëtare. Ajo gjithashtu ka punuar në projekte të ndryshme me Agjencitë e OKB-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare si Eurostat, ILO, UNODC, World Bank, Dfid, dhe FMN.

Ajo është anëtare e Institutit Ndërkombëtar të Statistikave (ISI) dhe Shoqatës Statisticienëve të Ballkanit. Ajo është një nga themeluesit e Institutit Agenda, një qendër kërkimesh ekonomike dhe sociale e themeluar në qershor të vitit 2006 në Tiranë.

Përgjate viteve ajo ka dhënë kontributin e saj në lëvizjen e gruas në Shqipëri duke qënë aktiviste në shumë nisma, por gjithashtu edhe në aksione të shoqërisë civile. Ajo ka shërbyer edhe si anëtare e Këshillit Bashiak të Tiranës për periudhën 2000-2011.

Ka qënë lektore në Universitetin e Tiranës, Universitetit Bujqësor si dhe në Universitetin “Zonja e Këshillit të Mirë”.

Ajo ka shkruar disa botime në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e statistikave, zhvillimit social dhe ekonomik, si dhe të përkatësisë gjinore. Zotëron shumë mirë gjuhën Angleze dhe Italiane si dhe një gjuhën Franceze.

ZV/MINISTRE

Znj. Adela KARAPICI mban titullin “Profesor i Asociuar” (2015) dhe “Doktor shkencash” në vitin 2012 i marrë në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Znj Karapici është diplomuar në Universitetin e Tiranës në vitin 2007, dega Ekonomiks. Ajo ka ndjekur dhe studimet master në “Studimet Ekonomike Europiane” në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës në bashkëpunim me Universitetin e Bambergut, Gjermani. Znj KARAPICI ka punuar si pedagoge në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës, që prej tetor 2007. Në Shkurt të vitit 2016 ajo është emëruar zëvendësministre në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.